



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I BASHKISË
TEPELENË**

Nr. 1966/2.....prot.

Tepelenë, më 09.11.....2024

VENDIM

Nr. 60 datë 31.10.2024

**PËR “PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR TË BASHKISË
TEPELENË DHE INSTRUMENTAVE VENDORE TË PLANIFIKIMIT, PJESË
PËRBËRËSE E TIJ.”**

Në mbështetje të nenit 9, pika 1.1, nenit 23, pika 14 dhe nenit 54 shkronja “k” të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” (i ndryshuar); të neneve 9 dhe 23 të Ligjit nr 107, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar, VKM nr 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit” e ndryshuar, të përcaktimeve të Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit dhe Ujit lidhur me përcaktimin e çështjeve , shpalljen e zonave dhe objekteve të rëndësisë kombëtare në planifikimin , të Strategjiave Sektoriale në fuqi, të normave teknike të planifikimit si dhe të dhënave elektronike bazë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak

V E N D O S I:

1. Miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tepelenë dhe instrumentave vendore të planifikimit, pjesë përbërëse e tij.
2. Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tepelenë, instrumentat vendore të planifikimit, pjesë përbërëse e tij, si dhe vendimi i miratimit nga Këshilli Bashkiak, t’i dërgohen brenda 15 ditëve nga data e miratimit, Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, për miratim përfundimtar nga Këshilli Kombëtar i Planifikimit të Territorit dhe Ujit.
3. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Tepelenë, Drejtoria e Planifikimit të Territorit, , për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn ne fuqi sipas nenit 55, pika 6 të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Valbona Çela

Miratuar me 9 vota

Vota Pro 9

Vota Kunder 1 vota

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 09.11.2024

KRYETAR

Arben Gumeni

